



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

RAPORT SPECIAL

TEMATIKA: Koordinator i Transparencës, bashkite Tiranë, Kamëz, Vorë

(version i shkurtuar per web)

1. Hyrje

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore i ka kushtuar një vëmëndje të posacme transparencës se bashkive me publikun. KREU VI i këtij ligji titullohet “**Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja Qytetare**”. Nenet e këtij kreu, përvecse bëjnë përcaktime të qarta, referojnë në mëse një rast ligjin 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” si dhe ligjin Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Neni 15 i ligjit për vetëqeverisjen vendore titullohet “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”. Ai përcakton shprehimisht se :

- 1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë transparencën e veprimtarisë së tyre.*
- 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.*
- 3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë **koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akes nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.***

2. Rezultatet e vleresimit

Për të vlerësuar zbatimin e nenit 15 të ligjit 139/2015, është i domosdoshëm vlerësimi i nder te tjera i caktimit të **Koordinatorit të Transparencës**, prashikimet normative për të cilin i përmban ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i cili i

cakton Autoritetit Publik, në rastin konkret bashkive Tiranë, Kamëz dhe Vorë, detyrimin për caktimin e ketij personeli te posaçem.

Koordinatori është person kyç në implementimin e kërkesave të ligjit dhe që mban përgjegjesi direkte në rast mos-përmbushjeje. Koordinatori për të drejtën e informimit i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik; krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit; bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj; regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre; dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;

Të dhënat koordinators duhet të afishohen publikisht, pa kërkesë dhe në faqen zyrtare të bashkisë (neni 7/1, germa “ç”). Nga të dhënat rezulton se të treja bashkitë, respektivisht Tirane, Kamez, Vore, kanë caktuar koordinator të informimit publik dhe të dhënat e tyre nominale dhe kontaktet respektive janë të afishuara në faqen zyrtare të internetit të secilës bashki, sikurse e konfirmon edhe tabela e mëposhtme.

Bashkia Tirane	Bashia Kamëz	Bashkia Vorë.
<p>kordinator ELENA XHAXHO elena.xhaxho@tirana.gov.al tel : 0692696043</p>	<p>kordinator ANA THANA ana.thana@yahoo.com</p>	<p>kordinator ERVIN DODA dodaervin007@gmail.com tel : 0682191611</p>
		

